



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1007/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e Sabri Micaj, Sekretar i Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr. 2948/2021, të datës 03.11.2021, për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1007/2021, i paraqitur nga Sabri Micaj, Sekretar i Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr. 2948/2021, të datës 03.11.2021, me të cilin ka kërkuar rinumërim votave për Subjektin Politik Nisma Socialdemokrate në vendvotimet: 2006A/01R, 2006A/01R, 2006A/01R, 2006A/01R.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021, nga Sabit Micaj, Sekretar i Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, me të cilin pretendon se në vendvotimet: 2006A/01R, 2006A/01R, 2006A/01R, 2006A/01R, ka pasur pa rregullsi në paraqitjen e rezultatit në mes të votave të cilat janë paraqitur në Formularët e Përputhjes së Rezultateve dhe të dëshmimeve të votuesve të subjektit politik Nisma Socialdemokrate. Parashtruesi i apelit kërkon që të bëhet rinumërimi i votave në këto vendvotime.

Si prove në apel parashtruesi ka bashkangjitur 9 kopje të letërnjoftimit si dhe kopje të FRP-ve dhe FRK-ve.

Apeli është i pabazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave të subjektit politik Nisma Socialdemokrate gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultat përfundimtar, si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli i shqyrtoi Formularët e bashkangjitur në apel nga ana e ankuesit, mirëpo gjeti se të njëjtit nuk janë bazë e mjaftueshme për të kolauduar se në këto vendvotime ka pasur parregullsi, rrjedhimisht pretendimi ankimor i parashtruesit të apelit se apelin e mbështet në pohimet e votuesve nuk është i argumentuar, për më tepër, paneli rikujton se vota është e fshehur, dhe publikimi i saj shpërfaq vullnetin e çdo votuesi në fletëvotim që është në kundërshtim me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret si fakt provues pretendimi i tillë se një votues pohon faktin se ka votuar në ndonjërin nga vendvotimet që apeluesi ka pretenduar në apel. Në rastin konkret apeluesi nuk ka paraqitur asnjë provë tjetër pos Formularëve të Përputhjes së Rezultateve dhe Formularët e Rezultateve të Kandidatëve, duke mos bashkangjitur asnjë deklaratë e cila do shërbente si provë, andaj në mungesë të provave paneli vendosi që apeli i paraqitur të refuzohet si i pa bazuar.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i paraqitur nga Sabri Micaaj, Sekretar i Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për subjektin politik Nisma Socialdemokrate, andaj kërkesa e apeluesit për të rinumëruar të gjitha fletëvotimet në vendvotimet e lartcekura, vlerësohet si i pa bazuar. Shkaqet për rinumërimin, e votave për subjektin në fjalë sipas vlerësimit të panelit do duhej të jenë shumë serioze dhe bindëse, si dhe të rezultojnë nga provat e mjaftueshme, bindëse dhe të pa kontestueshme, te cilat në rastin konkret mungojnë.

Për arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr 1007/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.